



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.331/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë paraqitur kundër subjektit politik Srpska Demokratija, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e subjektit politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, Anr.331/2025 datë 03.02.2025, e parashtruar kundër subjektit politik Srpska Demokratija, me seli në Mitrovicën e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 03.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti Za Slobodu, Pravdu i Opstanak me të cilën pretendon se ne po ngremë padi kundër partisë politike "Demokracia Serbe" për shpifje publike që cenoi integritetin personal dhe nderin e kryetarit të partisë sonë dhe ministrit për Komunitete dhe Kthim, Nenad Rashiq. Deklarata të rreme janë publikuar në disa media, përfshirë edhe rrjetet sociale, ku denoncojnë publikisht partinë Za Slobodu, Pravdu i Opstanak dhe ministrin, me pretendimin se kanë përdorur fushatën dhe kanë shpërndarë fonde për përfitime të partisë, gjë që është krejtësisht e pavërtetë. Përkatësisht, Ministria e udhëhequr nga ministri Rashiq organizon rregullisht ndarjen e ndihmave në formë të pakove ushqimore dhe mobilieve, thirrjeve publike dhe subvencioneve individuale dhe shpeshtësia e këtyre aktiviteteve varet nga nevojat aktuale dhe fondet në dispozicion.

Më tutje në ankesë është theksuar se të gjitha të dhënat përkatëse i kemi në arkivin tonë me foto dhe data, por nuk po i publikojmë sepse bashkëqytetarët tanë përballen me forma të ndryshme shantazhesh, të cilat mund t'i vërtetojmë, se ministria ka kryer procedurën e rregullt,

si gjithëherë. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që ta dënojë subjektin politik "Srpska Demokratija" dhe subjekti politik të mbajë përgjegjësi për përhapjen e informatave të rreme dhe gënjeshtreve.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur publikimin e medias-portalit Kosova Online.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 04.02.2025, subjekti politik Srpska Demokratija nuk pajtohet me pretendimet e deklaruara në ankesën e parashtruar nga partia e Nenad Rashiqit se ne kemi shpifur për partinë e lartpërmendur. Në mbështetje të këtij pretendimi, kanë paraqitur provat e mëposhtme: Zyra e partisë së Nenad Rashiqit ishte në hapësirat e të njëjta ku gjendet qendren e votimit në Leposaviq – më pas u dëbua partia e tij nga këto hapësira, me insistimin e Misionit Monitorues të Bashkimit Evropian (dëshmi për heqjen e materialit partiak pas insistimit tonë publik) që zyra e partisë të mos jetë në të njëjtin vend me qendrën e votimit – regjistrim). Më tutje në përgjigje në ankesë është theksuar se përfaqësuesit tanë e kanë raportuar këtë sjellje të paligjshme në Policinë e Kosovës, pas së cilës policët kanë ndaluar një person. Në rastin në fjalë, organet partiake të partisë së Nenad Rashiqit në hapësirat partiake premtajnë teknik të bardh, pako higjienike dhe ushqimore dhe mobilie në këmbim të votave për listën e tyre në zgjedhjet parlamentare (në incizim madje dëgjohet një përfaqësues i partisë së lartpërmendur duke përmendur numri për të cilin votohet, pra 132) Zvezdana Neshiq, anëtare e partisë së Nenad Rashiqit, në deklaratën e saj në rrjetin social Facebook deklaroi se Ministria për Komunitete dhe Kthim po përdor mjete edhe në fushatën zgjedhore. Përmes përgjigjes në ankesë i ka bërë thirrje Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia që të refuzojë ankesën e pabazuar të partisë së Nenad Rashiqit dhe të shqiptojë dënimin më të rreptë ndaj partisë së lartpërmendur për fushatë nga zyrtarët dhe keqpërdorimin e fondeve publike në këmbim të votave në zgjedhjet parlamentare.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

-Ankesa është e pabazuar.

Sipas Paneli, nga përmbajtja e ankesës referuar subjektit politik Srpska Demokratija rezulton se ankesa nuk i referohet asnjë shkelje konkrete të Ligjit për Zgjedhje dhe Rregullores Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, por pretendohet se ky subjekt politik ka bërë shpifje publike që cenojnë integritetin personal dhe nderin e kryetarit të partisë, njëherit Ministër për Komunitete dhe Kthim Nenad Rashiq. Si provë për këtë është bashkangjitur publikimi i medias-portalit Kosova Online. Paneli vlerëson se subjekti politik ankues nuk ka paraqitur prova që subjekti politik Srpska Demokratija të ketë bërë shkelje të nenit 34 të Ligjit për Zgjedhjet si dhe Rregullores Zgjedhore 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve.

Paneli ka vlerësuar se prova nga media-portalit Kosova Online nuk paraqet bazë për ndonjë shkelje të rregullave zgjedhore dhe se gjuha që pretendohet nga subjekti politik që është përdor nga subjekti tjetër politik nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nuk është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin në nen në mënyrë decisive thuhet se: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit*

apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Nga arsyet e theksuara me lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr. 331/2025 më datë 05.02.2025

**Kryesuesi i Panelit,
Kujtim Pasuli**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.